

**URDHËR**  
**Nr.565, datë 23.11.2011**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË “MASTER  
PROFESIONAL”, TË UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI” KORÇË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Hapjen në universitetin “Fan S. Noli” Korçë, të programeve të studimeve të ciklit të dytë, “Master profesional”, në:

a) Mësimdhënie, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master profesional”, në “Mësimdhënie”.

b) Marketing, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në “Marketing”.

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” kanë kohëzgjatje normale prej 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik dhe realizohen me 60 kredite “Master profesional në “Mësimdhënie”” dhe me 90 kredite “Master profesional” dhe “Marketing””.

3. Programet e studimeve të fillojnë në vitin akademik 2011-2012.

4. Programi i studimeve “Master profesional” në “Marketing” të plotësojë kushtet e përcaktuara në vendimin nr.254, datë 16.9.2011 të Këshillit të Akreditimit, bashkëlidhur këtij urdhri, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi tij.

5. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit “Fan S. Noli” Korçë, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Fan S. Noli” Korçë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Myqerem Tafaj**